



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/313
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300357/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë në Bulqizë.*

Drejtuar: **Z. Arben SULA**
Shef i Komisarariatit të Policisë

BULOIZË

Për dijeni: **Drejtues i parë Z. Dhimitraq ZIU**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

DIBËR

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Bulqizë.

Inspektimi u krye në datën 13.04.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme¹.

¹ Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Bulqizë, nr. K4/I67-2, datë 07.11.2022.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e rendit z. Ardian Balla, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit. Drejtuesi i Komisarariatit të Policisë Bulqizë z. Arben Sula atë ditë nuk ndodhej në institucion për shkak të një veprimtarie jashtë qytetit të Bulqizës. Është për tu theksuar se inspektimi ishte i pa njoftuar paraprakisht dhe nisur nga dinamika e institucionit kjo situatë është konsideruar brenda normalitetit të punës.

Në vijim, takimi i grupit të inspektimit vijoi me shefin e rendit z. Balla, i cili informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me përmirësimin sipas procedurave standarde të ambienteve të shoqërimit të këtij komisarati.

Grupi i inspektimit, pasi informoi shefin e rendit lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësën e policisë të zyrës së informacionit që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të dhomave të shoqërimit.

Grupi i punës, i shoqëruar nga shefi i rendit, inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit nuk kishte ndryshime në krahasim me inspektimin e fundit, duke patur parasysh standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve, si dhe rekomandimin e Avokatit të Popullit dërguar pas inspektimit të kryer në vitin 2022.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për dhënien e një kopjeje të kartës së të drejtave të personave që shoqërohen në ambientet e komisariateve që në momentin e hyrjes së tyre në Komisariatin Bulqizë.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për të vendosur posterat e rinj me të drejtat dhe kartën e të drejtave të personave që shoqërohen në ambientet e komisariateve, në vende që të jenë të aksesueshëm nga këta persona.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se:

3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/ marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion dhe ndërprerja e praktikës së marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në ambientet e zyrave të punës.

4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në të gjithë ambientet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për trajnimin e punonjësve të policisë në Komisariatin e Policisë Bulqizë, që kryejnë shërbim në ambientet e dhomave të shoqërimit, për zbatimin e rregullave të parashikuara në procedurën standarde për ruajtjen e trajtimin e personave të shoqëruar në këtë institucion.
7. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
8. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin me orendi të nevojshme të dhomave të shoqërimit me tavolina, si dhe pajisjen e tualeteve me lavamane dhe bolierë për ngrohjen e ujit për të qenë sa më funksional për personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë.

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të shoqërimit dhe respektimin e të drejtave të shoqëruarve, të ndaluarve/arrestuarve, rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen. Këto rekomandime nuk ju drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është qëndrim aspak serioz, mosreflektimi apo mbajtja e një qëndrimi zyrtar ndaj rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit dhe më parë CPT. Pavarësisht ndryshimit të vazhdueshëm të titullarëve të institucioneve, ata kanë detyrimin ligjor në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, të mbajnë qëndrimet e tyre zyrtare ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues vëren se megjithëse në Komisariatin e Policisë Bulqizë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, nisur nga kushtet aktuale, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja aktuale e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Në Komisariatin e Policisë Bulqizë, ambienti i shoqërimit ishte pjesërisht i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, duke krijuar 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete për femrat, personat e rritur dhe të miturit², të cilat ndodheshin në katin e parë të godinës kryesore.

² Kreu VI, pika 3 të procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me karrige për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, por mungonin tavolinat për të qenë një ambient i përshtatshëm për qëndrim sipas rasteve e në kushte përcaktuara nga ligji . Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4m x 3m, si dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Dhomat gjithashtu kishin edhe ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik.

Mjedisi dhe dhomat e shoqërimit nuk ishin të mirëmbajtura, të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, me ujë të rrjedhshëm 24 orë, por mungonin lavamane dhe bolierë për ngrohjen e ujit, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës së personave të shoqëruar në këtë institucion.

Në mjedisin e shoqërimit, grupi i inspektimit, nuk gjeti sende apo mjete të tilla prania e të cilave mund të shërbejë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar dhe të mitur. Kjo procedurë ndiqej nga punonjësit e policisë deri në përfundim të veprimeve procedurale me personat e shoqëruar, në zyrat e tyre të punës, të cilat nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Ndërsa, mjediset e dhomave të shoqërimit, ambientet e brendshme dhe pjesa e jashtme e tij ishin pjesërisht të survejuara me kamera përgjatë 24 orëve. Mbikëqyrja me kamera në të gjithë mjedisin e komisariateve, përveç mjediseve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen si nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura. Vlen të theksohet se ata shërbejnë për të garantuar besimin e qytetarëve te Policia e Shtetit.

Në Komisariatin e Policisë Bulqizë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 13.04.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 29 persona, sipas përcaktimeve të bëra përkatësisht në nenin 109 “Shoqërimi në polici” dhe

në paragrafin 1 të nenit 112 “Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit” të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar³.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që ju bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

Gjithashtu u informuam se karta e të drejtave të njeriut i jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar apo arrestuar, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisariatit duke garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar sugjeron dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në komisariat⁴ dhe plotësimin e regjistratve në dinamikë dhe jo në momentin kur largohen nga ambientet e komisariatit.

Në evidentimin e disa praktikave të njëpasnjëshme rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë së komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Bulqizë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin menjëherë pas përfundimit të veprimeve procedurale, në dhomat e sigurisë së Komisarlatin të Policisë Dibër.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe trajtimi i tyre

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”⁵ dhe “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”⁶, parashikohet se çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Bulqizë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform

³ Paragrafi 1 i nenit 112 parashikon se: “Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime: 1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për: a) gjeneralitetet; b) vendbanimin; c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; ç) punën që kryen; d) arsyet e shoqërimit; dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi; ë) punonjësën e policisë, i cili ka kryer shoqërimin”.

⁴ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohe të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

⁵ Kreu VII, pika 5 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁶ Kreu XI, pika 1 e 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

parashikimeve ligjore të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë së zyrës të informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁷. Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Për këtë fakt, kërkuam shpjegime dhe na u njoftua se asnjë nga personat e shoqëruar dhe arrestuar nuk ka paraqitur ankesë me vullnet të plotë.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarati i Policisë Bulqizë ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2022 nuk kishte pasur veprime për të miturit në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisariateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin⁸.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Bulqizë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara

⁷ Kreu VIII “Procedura të Dokumentimit të Veprimit të Shoqërimit” parashikuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁸ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Avokati i Popullit, duke ju referuar edhe standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Ky standard ndërkombëtar është parashikuar edhe në nivel kombëtar dhe shërben si për parandalimin e keqtrajtimit, por edhe në garantimin e besimit tek forcat e Policisë së Shtetit⁹.

Sipas përcaktimit të kreut VII pika 5/ç, të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”, parashikohet se: “Personat e shoqëruar deri në sqarimin e pozitës dhe arsyes së shoqërimit, mbahen në ruajtje dhe monitorim të punonjësit të policisë së funksionit të caktuar ose me mjete të tjera digjitale (sisteme të kamerave video-audio)” dhe në vijim të kreut XIV, pika 6/b, përcaktohet se: “Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të të arrestuarve/ndaluarve duhen regjistruar në elektronikë procesi i marrjes në pyetje apo veprimet e tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit”.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Gjithashtu Komisariati i Policisë Bulqizë në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues tek fëmijët.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga komunikimi me punonjësit e policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë, të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

⁹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Punonjësit e policisë informuan grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Bulqizës. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Bulqizë ishte zhvilluar konform ligjit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme, ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse, një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Ndërsa në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë për të marrë ndihmën mjekësore në Spitalin e Bulqizës.

Përsa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse, për të mundësuar rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Bulqizë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të

ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit¹⁰.

3. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në të gjithë ambientet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin me orendi të nevojshme të dhomave të shoqërimit, me tavolina, si dhe pajisjen e tualeteve me lavamane dhe bolierë për ngrohjen e ujit, për të qenë sa më funksionale për personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë.
7. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë shtetit, për analizimin e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kompetencë të këtij institucioni, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI

¹⁰ Kreu VII, pika 4/d e Procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.